



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr _____ Prot

Pogradec, me 24.08.2022

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Rehabilitim dhe ambjente shtese, këndi i lojrave me dorë "Arefi Berberi"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pune Ndertimore 45;

Pune Ndertimi 45000000 – 7;

Punime ndertimi per palestra – 45212222 – 8;

Punime ngrohje – 45232141 – 2;

Punime hidraulike dhe sanitare – 45330000;

VLERA E FONDIT LIMIT:

108 524 683 (Njëqind e tetë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre)

leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe merre persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021 -2022 sipas afateve të percaktuara në ligjin 9632/2006 ” *Per sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar. Kesaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- situacion punimesh
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 2	B	Ndertime civile dhe industriale
N.P - 3	B	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
N.P - 12	A	Punime te inxhinerise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S- 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
--------	---	----------------------------------

N.S- 2	A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S - 4	B	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
N.S – 8	A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri
N.S – 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S – 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S - 18	A	Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gjermimi në tokë	Gërmim themele e plinta b>2m esk.goma shk. Auto Gërmim dheu me makineri per oborrin e ambientin sportive Gërmim dheu me mak. kanale K.U.B e themel	0-20 mln leke	795.976
N.P-2 B	Ndertime civile dhe industriale	Ndertim mur tulle me bira 20cm Ndertim mur tulle me bira 12cm Brez b/a mbi mur tulle C 16/20 + arkitrare F.v hekur betoni ø = 6 ~10 mm F.v hekur betoni ø > 10mm Çati me kapriate metalike me HD 10~12m, Shtrese betoni nen plinta C 6/10 Brez b/a mbi xokol C 16/20 Mbulim me panele sanduich I ambientit ekzistues +ambient I ri Shtrese betoni C 7/10 kat perdhe + trotuari	21-50 mln leke	26.588.825

		Shtrese betoni C 7/10 katet per nivelim t=3cm Shtrese betoni C 12/15 h=15cm		
N.P-3 B	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Suvatim me Grafjato h> 4m Boje hidroplastike importi cil.I ne fasade H/izolim me dy duar bitum Shtrese me pllaka gres importi + plintuset Shkalle mermeri montazhi t=3cm F.v davanciale mermeri ne dritare t=2cm Veshje muresh me pllaka Parapet shkalle me tubo inoksi ne shkalle h=90cm Veshje fasade e ventiluar gips cimentato + aksesoret e montimit (WM113.2)+finiture decoquartz Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem Shtrese polisterini 28kg/m3 t = 4cm	21-50 mln leke	22.465.640
N.P-12 A	Punime të inxhinerisë së mjedisit	Punime per mbrojtjen e mjedisit vendgrumbullimin e materialit te dale nga germimi, uljen e nivelit te pluhurave, zhurmave. Referuar dhe ne termat e references	0-20 mln leke	
N.S- 1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur tulle me pastrim Prishje solete b/a Prishje shtresa betoni Prishje mur tulle me pastrim ne klasa dhe oxhake Ç'montim dyer/dritare, metalike, d/alumin dhe druri Ç'montim kangjella metalike Prishje suvatim I brendshem Prishje suvatim tavani Prishje suvatim I jashtem Prishje davanciale dritare dhe bazamake shkalle Prishje shtrese me pllaka granili dhe nenshtresat Prishje cati vendi	0-20 mln leke	1.499.251
N.S- 2. A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.V. Tub HDPE I Brinjuar SN 8 Dn = 200 mm Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize Pusete b/a kontrolli 60 x 60, h = 100 cm, me kapak gize Pajisje hidrosanitare	0-20 mln leke	861.250
N.S-4. B	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	Suvatim mure te brendeshme Suvatim tavane Boje hidroplastike mure te brendshme Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm, taraca Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Veshje kornize llamarine xingato Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120 Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33cm F.v dyer te brendshme druri tamburato te rimersuara F.v dyer duralumini me mbushje d/a (wc) F.v dere duralumini e jashtme F.v vetrata duralumini dopio xham F.v porte metalike rreshqitese Shtrese jastek gome me, t mesatare= 3cm Ndenjese tek shkallaret Punime palestra	21-50 mln leke	20.748.918

N.S – 8 A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	Plinta b/a monolite C 16/20 Trare themeli monolit b/a C - 16/20 Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m Trare e arkitrare b/a C- 20/25 Soleta te plota b/a C - 20/25 Konstruksione metalike Zgare hekuri Ø 8mm cdo 20/20cm F. Vendosje tabela per koshat e basketbollit+struktura mbajtse F. V shtylla volejboli F. v rrjete volejboli F.V porta futbollit te vogla	0-20 mln leke	15.615.087
N.S – 12 A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	Punime ne sallën e kaldajës) Furnizim - instalim tubo çeliku per ngrohje se bashku me rakorderite dhe mbeshitetet perkatese Aparatet ngrohës (radiatoret) Pajisje Furnizim - instalim i pulteve shperndares me te gjithë elementet dhe aksesoret perkates Furnizim - instalim tubo me shume shtresa Pex - Al - Pex,φ(16 x 2) mm ne dyshe me Furnizim - instalim radiatorësh te kompletuar Sistemi i sinjalizimit te zjarrit Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit	0-20 mln leke	5.694.396
N.S – 14 A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Rrjeti fuqise. Furnizimi i kuadrove Kuadri kryesore ne katin perdhe KK Kuadri i Katit perdhe Kuadri I Katit te pare Kuadri i Palestres Sistemi i fuqise, ndricimit dhe sinjalizimit Sistemi kompjuterik dhe telefonik Sistemi i vëzhgimit CCTV Sistemi i Fonise Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike Ndricimi i Terrenit Sportiv Ndricimi i ambienteve	0-20 mln leke	9.328.970
N.S–18. A	Punime topogjeodezike	RILEVIM TOPOGRAFIK, Ne referim termat e references	0-20 mln leke	

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe pika 5/c e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne përmbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji Nr.9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta” (te ndryshuar). Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve t ngurta, nepermjet administrimit

mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin dhe asgjesimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim apo asgjesim i mbetjeve te ndryshme ndertimore.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi tipi III.1.B “Menaxhim i Mbetjeve” për aktivitetin ID 5.6 pika b) Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe Gurë) ; 20 03 07 (Mbetje të vëllimshme) ; 20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara).

Në rast bashkimi operatorësh të paktën njëri nga operatorët duhet të jetë i pajisur me Lejen e mësipërme në raport me zërat që ka marrë përsipër të kryejë;

Në rast se kjo leje nuk disponohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, AK me qëllim gjithëpërfshirjen dhe rritjen e konkurrencës do të pranojë paraqitjen e një kontrate Shërbimi nga subjektet të cilët disponojnë këtë leje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe pika 5/c e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e mjedisit”, te ndryshuar.

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin grumbullimin, ndarjen ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjesimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme.

Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje dhe germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim I perkohshem I tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave te çdo lloji te leshuar nga QKL. Kodi I.2.A.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a dhe pika 5/c e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji Nr. 152/2015 Për Shërbimin E Mbrojtjes Nga Zjarri Dhe Shpëtimin.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)

- Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në Listëpagesat të pakten për periudhën maj-korrik 2022 si dhe të figurojnë në licensën e shoqërisë. Per secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.
-

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Inxhinieri i mjedisit është vendosur me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit të lidhur ngushtësisht me punimeve e parashikuara në preventiv dhe përshkrimin e relacionit teknik Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi	Punime ndertimi ne referim termat e references
1 (nje) Inxhinier Hidroteknik	Punime hidrosanitare ne referim termat e references
1 (nje) Inxhinier Elektrik	Punime elektrike ne referim termat e references
1 (nje) Inxhinier Mekanik	Punime mekanike ne referim termat e references
1 (nje) Inxhinier Gjeodet	Rilevim Topografik
1 (nje) Inxhinier Mjedisi	Punime per mbrojtjen e mjedisit vendgrumbullimin e materialit te dale nga germimi, uljen e nivelit te pluhurave, zhurmave

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.

2.3.7. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licensën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik
- 1 (nje) Inxhinier Mekatronik

Per secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.

si dhe të figurojnë në Listëpagesat të pakten për periudhën maj-korrik 2022

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi	Punime ndertimi/ Punime Germimi dhe Prishje
1 (nje) Arkitekt	Punime fasadash dhe te tjera lidhur me to
1 (nje) Inxhinier Elektronik	Punime per Instalime kompjuterike, telefonie, citofoni
1 (nje) Inxhinier Mekatronik	Punime te Rrjetit te ngrohjes

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën maj-korrik 2022 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Shënim: *Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor*

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe te mbrojtjes se shenderit ne pune" (i ndryshuar) i cili percakton "2/1. Punedhësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndennarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike dhe12/2. Per subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të kësaj vendimi, marrja në punë e mjekut të ndennarrjes është e detyrueshme për ato ndennarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës ... Mjeku i ndennarrjes ofron keshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të semundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson çështjet e fiziologjise së punës, të problemeve higjienike e sanitare, vecanerisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert për dhenien e ndihmes së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave" e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë", e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje inxhinjer si “Ekspert zjarrfikes” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.
- 4 (kater) Punonjes Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I. Renia nga lartesi, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rëndesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Per punimet ne lartesi" ose ekuivalente nepermet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik. qe mund te shfaqet gjate punimeve ne lartesi dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi. Duke iu referuar preventivit te pasqyruar ne DST parashikohen ngritje skelash dhe punime ne to, ne lartesi nga 5m deri 12 m .Gjithashtu kerkesa per Ekspert zjarrfikes eshte në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri

dhe shpëtimin”, duke patur parasysh qe nje ze i rendesishem ne preventiv eshte edhe Sistemi i Mbrojtjes kunder Zjarrit

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 180 (njqind e tetedhjetë) persona për periudhën maj-korrik 2022 e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën maj-korrik 2022.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën maj-korrik 2022.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje janar - mars 2022, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e këtij kriteri është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.*

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevoje e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

NR. ANALIZE	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ore pune/njesi	ore pune total
2.426/4	Prishje solete b/a	m ³	5.6	25.70	144
2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	m ³	26	6.20	161
2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	5.6	18.80	105
2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim ne klasa dhe oxhake	m ³	2.5	6.20	16
Anal	Ç'montim dyer/dritare, metalike, d/alumin dhe druri	m ²	117	0.50	59
Anal	Ç'montim kangjella metalike	m ²	70	1.00	70

Anal	Prishje suvatim I brenshem	m ²	1,325	0.50	663
Anal	Prishje suvatim tavani	m ²	1,005	0.50	503
Anal	Prishje suvatim I jashtem	m ²	1,256	0.80	1005
Anal	Prishje davanciaie dritare dhe bazamake shkalle	m ³	22	2.20	48
Anal	Prishje shtrese me pllaka granili dhe nenshtresat	m ²	1,005	2.20	2211
Anal	Prishje cati vendi	m ²	1,100	2.20	2420
2.37/5b	Transport dheu,mat. ndertimi me auto deri 10.0 km	m ³	252		
II. PUNIME GERMIMI					
2.26	Germim themele e plinta b>2m esk.goma shk. Auto	m ³	197	0.62	122
2.37/5b	Transport mbeturina ndertimi me auto deri 10 km	m ³	197.0		
III. PUNIME BETONI E BETON ARME					
2.262	Shtrese betoni nen plinta C 6/10	m ³	14.4	8.60	124
2.114/1	Plinta b/a monolite C 16/20	m ³	80	6.93	554
2.116/1	Trare themeli monolit b/a C - 16/20	m ³	40	15.33	613
2.121/1	Brez b/a mbi xokol C 16/20	m ³	13	22.89	298
2.117/1a	Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m	m ³	90	31.22	2810
2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C- 20/25	m ³	240	20.60	4944
2.122/1a	Soleta te plota b/a C - 20/25	m ³	280	22.89	6409
Fv	F.v hekur betoni $\phi = 6 \sim 10$ mm	ton	34.85	60.00	2091
Fv	F.v hekur betoni $\phi > 10$ mm	ton	50	42.00	2100
Fv	Konstruksione metalike	ton	14	36.00	504
IV. PUNIME MURATURE E SUVATIMI					
2.86	Ndertim mur tulle me bira 20cm	m ³	98	14.00	1372
2.84	Ndertim mur tulle me bira 12cm	m ³	73	15.80	1153
2.121/1	Brez b/a mbi mur tulle C 16/20 + arkitrare	m ³	14	22.89	320
2130	Suvatim mure te brendeshme	m ²	2450	1.55	3798
2300	Suvatim tavane	m ²	1298	2.85	3699
2.308/a	Suvatim me Grafjato h> 4m	m ²	100	3.50	350
2.404	Boje hidroplastike mure te brendshme	m ²	3748	0.36	1349
2.404/1	Boje hidroplastike importi cil.I ne fasade	m ²	100	0.36	36
V. PUNIME H/IZOLIMI DHE ÇATIE					
An	Mbulim me panele sandwich I ambientit ekzistues +ambient I ri	m ²	1260	1.00	1260
2.22+p	Çati me kapriate metalike me HD 10~12m,	m ²	160	1.40	224
2.239/a	Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm, taraca	m ²	300	0.75	225
2.200	Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	m ²	300	0.65	195
2.203	Veshje kornize llamarine xingato	m ²	120	1.60	192
2.209/b	Ulluk shkarkimi vertikal me baker ϕ 120	ml	140	0.55	77
2.212/b	Ulluk shkarkimi horizontal me baker 33cm	ml	152	0.79	120
VI. PUNIME SHTRESASH					
2.262/1	Shtrese betoni C 7/10 kat perdhe + trotuari	m ³	47	8.60	404
2.262	Shtrese betoni C 7/10 katet per nivelim t=3cm	m ³	24	8.60	206
2.195	H/izolim me dy duar bitum	m ²	286	0.42	120
2.267/b	Shtrese me pllaka gres importi + plintuset	m ²	1298	2.46	3193
2.268/a	Shkalle mermeri montazhi t=3cm	m ²	46	2.30	106
2.273	F.v davanciaie mermeri ne dritare t=2cm	m ²	57	4.50	257
2.326	Veshje muresh me pllaka	m ²	359	3.70	1328

2.410/a	Parapet shkalle me tubo inoksi ne shkalle h=90cm	ml	55	2.20	121
An	Veshje fasade e ventiluar gips cimentato + aksesoret e montimit (WM1113.2)+finiture decoquartz	m ²	1114	5.50	6127
An	Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem	m ²	600	5.50	3300
analize	Shtrese polisterini 28kg/m ³ t = 4cm	m ³	23.2	0.75	17
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 h=15cm	m ³	58.0	8.60	499
2.166	Zgare hekuri Ø 8mm cdo 20/20cm	ton	2.4	60.00	144
An	Shtrese jastek gome me, t mesatare= 3cm	m ²	580.0	0.30	174
Analize	Ndenjese tek shkallaret	copë	700	0.50	350
VII. PUNIME DYER DRITARE					
2.388/1	F.v dyer te brendshme druri tamburato te rimersuara	m ²	47	2.00	94
2.395/a	F.v dyer duralumini me mbushje d/a (wc)	m ²	44	2.40	106
2.395/a	F.v dere duralumini e jashtme	m ²	3	2.40	7
2.373/1	F.v vetrata duralumini dopio xham	m ²	127	2.62	333
2.An	F.v porte metalike rreshqitese	m ²	13	2.46	32
VIII.PUNIME TE NDRYSHME					
Analize	F. Vendosje tabela per koshat e basketbollit+struktura mbajtse	copë	2.0	1.00	2
Analize	F. V shtylla volejbolli	copë	2.0	1.00	2
Analize	F. v rrjete volejbolli	copë	1.0	1.00	1
Analize	F.V porta futbollit te vogla	copë	2.0	1.00	2
IX. PUNIME SISTEMIMI I JASHEM					
3.89/b	Gërmim dheu me makineri per oborrin e ambientin sportiv	m ³	54	0.17	9
3.207	Shtrese çakelli t = 10 cm	m ²	256	0.04	10
3.212/a	Shtrese stabilizanti t = 5 cm	m ²	256	0.05	13
2.286+pr	Shtrese pllaka betoni C 16/20 t = 6 cm, oborri para shkolles, mbi shtrese rere 5cm	m ²	256	1.05	269
3.619/a	Bordura betoni C.16/20 6 x 20 cm (gjelberimi)	ml	74	0.53	39
3.617/1	F V bordura betoni 15x30 cm	m	70	0.75	53
3.88/a	Germim dheu me mak. kanale K.U.B e themel	m ³	18	0.17	3
2.523	F.V. Tub HDPE I Brinjuar SN 8 Dn = 200 mm	ml	50	1.90	95
2.261	Shtrese rere rreth tub.plastik	m ³	15	2.18	33
3.An-9	Mushje ngjeshje me zhavorr te imet mbi tub	m ³	18	0.04	1
2.An - 23	Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	2	5.60	11
2.575+pr	Pusete b/a kontrolli 60 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	1	50.30	50
SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT					
Hydrant Zjarri dhe grupi i motopompes					
Analize	F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 -U.N.I 9227 me baze rezine.Dimensionet (370x610x190) mm,	komp l	3	20.00	60
Analize	Vendosja në kasetë të jashtme, llamarine çeliku të emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2"	komp l	1	20.00	20
An - 12	F V rezervuari zingato 2000 litra	cope	2	36.00	72
Stacioni i Pompave te Zjarrit , I kompletuar me panel elektrik etc.					

	Fikëse zjarri me bombula				
Analize	F.V Fikëse zjarr pluhur karelato, destinacioni per depozitat e lendes djegese, transformatorin. Tip karelato (e levizshem).	cope	2	1.50	3
Analize	F.V Fikëse zjarr -me lpluhur p,adceitsettiinnacoioirromnai lpe5r0mkbgr, opjetjsehnae82.5 paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-	cope	12	1.50	18
	Pajisje hidrosanitare				
An - 15	F.V Boiler elektri 100 lit, tip horizontal + aksesoret hidraulike	cope	1	7.00	7
